

LIGJ
Nr.7379, datë 8.5.1990

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJE E DEKRETE

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.3766, datë 17.12.1963 “Për shërbimin shëndetësor dhe dhënien falas të ndihmës mjekësore të shtetit”, nënenin 6 paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Në ndihmë mjekësore përfshihet edhe dhënia e barnave falas për mjekime jashtë institucioneve shëndetësore, në rastet që përcaktohen nga Ministri e Financave me Ministrinë e Shëndetësisë”.

Neni 2

Në ligjin nr.5842, datë 20.2.1979 “Për të ardhurën neto të centralizuar nga kooperativat bujqësore”, neni 5 ndryshohet si vijon:

“Ministria e Financave, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, mund të bëjnë përfundime të lehtësira për tërheqjen e të ardhurës neto të centralizuar nga kooperativat bujqësore”.

Neni 3

Në ligjin nr.6340, datë 26.6.1981 “Për miratimin e Kodit Civil të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë bëhen këto ndryshime:

1. Neni 44 ndryshohet si vijon:

“Njësitë ekonomike që organizohen brenda ndërmarrjes me bilanc më vete, miratohen nga ndërmarrjet. Për ato që do të kenë llogari likuiduese, merret edhe pëlqimi i bankës në rreth”.

2. Neni 150 ndryshohet si vijon:

“Këshilli i Ministrave ose, në raste të veçanta Kryesia e tij, kur ngarkohet prej Këshillit të Ministrave, mund të nxjerrin kontrata tip të detyrueshme për kategori të caktuara kontratash që lidhen ndërmjet ndërmarrjeve, institucioneve dhe kooperativave bujqësore, si dhe ndërmjet këtyre shtetasve”.

Neni 4

Në ligjin nr.6802, datë 29.6.1983 “Për hartimin , miratimin dhe zbatimin e planit unik e të përgjithshëm të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës popullore të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, në nenin 4, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Këshilli i Ministrave ka të drejtë t’i bëjë përmirësime planit ose, në raste të veçanta, të ngarkojë Kryesinë e tij për t’i bërë këto përmirësime, pa ndryshuar treguesit e përgjithshëm të miratuar nga Kuvendi Popullor”.

Neni 5

Në dekretin nr.1122, datë 26.7.1950 “Për tatimin mbi xhiro të ndërmarrjeve ekonomike”, në nenin 6, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Tarifat e tatimit mbi xhiro për mallrat që shiten nga ndërmarrjet ekonomike, caktohen nga Ministria e Financave, në bashkëpunim me organet përkatëse”.

Neni 6

Në dekretin nr.4864, datë 15.7.1971 “Për krijimin e kooperativave bujqësore të tipit të lartë”, neni 2 ndryshohet si vijon:

“Kooperativa bujqësore e tipit të lartë krijohet mbi bazën e kooperativave bujqësore ekzistuese, me vullnetin e lirë të anëtarëve të tyre dhe me miratim të Kryesisë së Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Në dekretin nr.4945, dastë 10.3.1972 “Për dërgimin e shtypshkrimeve bibliotekave”, në nenin 2, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Në kuptim të këtij dekreti quhen shtypshkrime: librat, gazetatat, rrevistat, buletinet e çdo kategorie, dispensat, hartat, atlaset, pllakatet, portretet, albumet, riprodhimet e veprave të artit, kalendarët e të gjitha tipave, fotoekspozitat (e shtypshkruara), parullat, mjetet figurative në ndihmë të nxënësve e të mësuesve, si dhe çdo lloj burimi tjetër që caktohet nga Komiteti i Kulturës dhe i Arteve”.

Neni 8

Në dekretin nr.6809, datë 21.7.1983 “Për kalimin ose thithjen e kooperativave bujqësore nga ndërmarrjet bujqësore”, neni 2 ndryshohet si vijon:

“Kalimi i një kooperative bujqësore në ndërmarrje bujqësore, si dhe thithja e një kooperative bujqësore ose e sektorëve të veçantë të saj, nga një ndërmarrje bujqësore, bëhet mbi bazën e vullnetit të lirë të anëtarëve me vendim të jo më pak se dy të tretave të mbledhjes së përgjithshme të kooperativës bujqësore dhe me miratim të Kryesisë së Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Dekreti nr.7179, datë 20.11.1987 “Për një ndryshim në dekretin nr.5747, dastë 29.6.1978 “Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve e të fshatrave”, shfuqizohet.

Neni 10

Çështjet për cenim pronësie, të pashqyrtuara nga zyrat e urbanistikës e të projektimit deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të shqyrtohen nga gjykata e rretheve.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi më 1 qershor 1990.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA